
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data 03/09/2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: "Blerje dhe instalim kondicionerësh për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit dhe zyrat përmbarimore vendore"

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

42512000-8 Instalimet e ajrit të kondicionuar
39717200-3 Pajisje të ajrit të kondicionuar
45331220-4 Instalime kondicionerësh

Vlera e fondit limit: 2,910,777 (dy milionë e nëntëqind e dhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit për objektin që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar ” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) Në furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 42 pika 3, nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe

profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh se vlera e fondit limit për të gjitha lotet është nën kufirin e ulët monetar dhe përcaktimeve të bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcakton se: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

2.3.2 Operatori ekonomik për realizimin e montimit të artikujve objekt prokurimi duhet të disponojë liçenesë të lëshuar nga Ministria e Infrastruktës dhe Energjisë për Impiante teknologjik, termike sipas kategorisë:

- **NS 12-A (Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit)**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me këtë kategori license N.S – 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale për kryerjen e shërbimit të montimit/instalimit, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe mbështetur në

Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e ndryshuar si edhe në VKM-në Nr.943 dt 28.12.2016 për disa shtesa në vendimin Nr. 759 dt 12.11.2014 të Keshillit të Ministrave për “Licensimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Ky kriter është kërkuar në mënyrë që të garantohet dhe të sigurohet Autoriteti Kontraktor përfitues që Operatori ekonomik ofertues zotëron kapacitetet dhe përvojën e nevojshme për të instaluar/montuar dhe konfiguruar pajisjet.

2.3.3 Operatori Ekonomik për kryerjen e shërbimit të montimit të artikujve objekt prokurimi duhet të ketë të punësuar stafin e tij teknik si më poshtë:

- Të paktën **1 (një) Inxhinier mekanik;**

-Të paktën **2 (dy) Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse;**

Operatori ekonomik në lidhje me stafin teknik të kërkuar më sipër duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

Për inxhinierin mekanik

- Kontratë pune të vlefshme;
- CV
- Diplomë
- Listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Për Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse;

- Kontratë pune të vlefshme ose kontratë bashkëpunimi;
- CV
- Çertifikatë/Diplomë/Dëshmi kualifikimi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

Shënim: Kriteri Nr.2.3.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të nenit të 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të

kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Punonjësit e sipërpërmendur kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit. Vendosja e inxhinierit mekanik dhe instaluesve siguron që procesi i montimit dhe riparimit të pajisjeve të kryhet me standarde të larta profesionale. Kualifikimet dhe eksperiencia e stafit teknik minimizojnë rrezikun e problemeve teknike në pajisje pas instalimit. Kërkimi i diplomave dhe certifikatave garantojnë kualifikimin e personelit të angazhuar në këtë proces. Stafi teknik i kualifikuar sjell efikasitet në procesin e instalimit dhe mirëmbajtjes, duke kursyer kohë dhe burime, si dhe duke shmangur ndërprerjet e mundshme në funksionimin e pajisjeve. Inxhinieri mekanik është i rëndësishëm për të mbikqyrur dhe siguruar instalimin korrekt të pajisjeve komplekse si kondicionerët dhe sistemet ftohëse-ngrohëse. Kjo redukton çdo rrezik që mund të vijë nga instalime jo të sakta. Dy instalues dhe një inxhinier mekanik në raport edhe me kohën e dorëzimit dhe kryerjes së montimit janë mëse të domosdoshëm për të punuar në mënyrë efektive në realizimin me sukses të kontratës. Lidhur me kërkesën për instaluesit e kondicionerëve AK jo domosdoshmërisht kërkon që instaluesit të jenë staf i qëndrueshëm i ofertuesit të mundshëm ekonomik por mund të kontraktohen nga operatorët ekonomikë të interesuar për realizimin e objektit të prokurimit. Ky përcaktim në këtë mënyrë është bërë duke mbajtur parasysh parimet dhe vetë qëllimin e ligjit të prokurimit siundër janë nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitja e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë siguri i një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; si edhe siguri i integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë dhe ti provojnë Autoritetit Kontraktor se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë / skeda teknike për artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. (Katalogët / skedat teknike duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / skedës teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë AK - Organit Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues për llogari të të cilit Organi Qëndror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001:2015(ose e përditësuar) “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur ne përputhje me nenin 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Grupi i punës i Autoritetit Kontraktor përfitues iu referua "Katalogut të blerjes së pajisjeve të kondicionimit", të publikuar në faqen zyrtare të Operatorit të Blerjeve të Përqendruara dhe të përditësuar më datë 03.12.2025, nga ku përcaktoi llojin e kondicionerëve dhe specifikimet teknike, si më poshtë:

Lloji i kondicionerit	Sasia
Kondicioner Inverter 9000 BTU	6 copë
Kondicioner Inverter 12000 BTU	30 copë
Kondicioner Inverter 18000 BTU	1 copë

Sasia totale: 37 (tridhjeteeshtatë) copë.

a. Specifikimet teknike minimale për Kondicioner Inverter 9000 BTU, me përmasa referuese 798 × 295 × 372 mm

- Kondicioner Inverter Mural 9000 BTU/h;
- Kapaciteti termik në ftohje (mesatar): 2.5 kW;
- Kapaciteti termik në ngrohje (mesatar): 3.6 kW;
- Fuqia elektrike: 0.40–0.62 kW;
- SEER = 9.36–9.54;
- SCOP = 5.1–5.9;
- EER = 4.5–6.1;
- COP = 4.65–5.8;
- Sasia e ajrit në ftohje (mesatare): 310–470 m³/h;
- Sasia e ajrit në ngrohje (mesatare): 350–490 m³/h;
- Niveli i zhurmës: 20–26 dB(A);
- Temperatura minimale e punës: -15°C;
- Klasa e efikasitetit energjetik: A+++ / A++;
- Gaz ftohës: R32;
- Pajisur me Wi-Fi.

Pajisja duhet të plotësojë kërkesat e standardeve EN/ISO, duke qenë në përputhje me standardet evropiane EN 14511, EN 378 dhe EN 14825, të cilat lidhen me efikasitetin energjetik dhe sigurinë e sistemeve të kondicionimit.

Gjithashtu, pajisja duhet të jetë në përputhje me kërkesat RoHS dhe WEEE, për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme dhe riciklimin e pajisjeve, si dhe të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit (Declaration of Conformity – DoC) të prodhuesit.

Pajisja duhet të jetë e pajisur me certifikimin CE, të jetë në përputhje me kërkesat ErP, si dhe të disponojë etiketën e efikasitetit energjetik dhe/ose deklaratën e konformitetit.

b. Specifikimet teknike minimale për Kondicioner Inverter 12,000 BTU, me përmasa referuese 798 × 295 × 372 mm

- Kondicioner Inverter Mural 12,000 BTU/h;

- Kapaciteti termik në ftohje (mesatar): 3.5 kW;
- Kapaciteti termik në ngrohje (mesatar): 5.0 kW;
- Fuqia elektrike: 0.66–1.00 kW;
- SEER = 8.7–9.1;
- SCOP = 5.2–5.77;
- EER = 5.1–5.35;
- COP = 4.8–5.1;
- Sasia e ajrit në ftohje (mesatare): 300–336 m³/h;
- Sasia e ajrit në ngrohje (mesatare): 340–420 m³/h;
- Niveli i zhurmës: 20–30 dB(A);
- Temperatura minimale e punës: -15°C;
- Klasa e efikasitetit energjetik: A+++/A++;
- Gaz ftohës: R32;
- Pajisur me Wi-Fi.

Pajisja duhet të plotësojë kërkesat e standardeve EN/ISO, duke qenë në përputhje me standardet evropiane EN 14511, EN 378 dhe EN 14825, të cilat lidhen me efikasitetin energjetik dhe sigurinë e sistemeve të kondicionimit.

Gjithashtu, pajisja duhet të jetë në përputhje me kërkesat RoHS dhe WEEE, për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme dhe riciklimin e pajisjeve, si dhe të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit (Declaration of Conformity – DoC) të prodhuesit.

Pajisja duhet të jetë e pajisur me certifikimin CE, të jetë në përputhje me kërkesat ErP, si dhe të disponojë etiketën e efikasitetit energjetik dhe/ose deklaratën e konformitetit.

c. Specifikimet teknike minimale për Kondicioner Inverter 18,000 BTU, me përmasa referuese 798 × 295 × 372 mm

- Kondicioner Inverter Mural 18,000 BTU/h;
- Kapaciteti termik në ftohje (mesatar): 5.0 kW;
- Kapaciteti termik në ngrohje (mesatar): 6.3 kW;
- Fuqia elektrike: 1.10–1.41 kW;
- SEER = 7.2–8.7;
- SCOP = 4.3–5.6;
- EER = 3.09–4.55;
- COP = 3.5–4.47;
- Sasia e ajrit në ftohje (mesatare): 500–865 m³/h;
- Sasia e ajrit në ngrohje (mesatare): 580–995 m³/h;
- Niveli i zhurmës: 30–40 dB(A);
- Temperatura minimale e punës: -15°C;
- Klasa e efikasitetit energjetik: A+++/A++;
- Gaz ftohës: R32;
- Pajisur me Wi-Fi.

Pajisja duhet të plotësojë kërkesat e standardeve EN/ISO, duke qenë në përputhje me standardet evropiane EN 14511, EN 378 dhe EN 14825, të cilat lidhen me efikasitetin energjetik dhe sigurinë e sistemeve të kondicionimit.

Gjithashtu, pajisja duhet të jetë në përputhje me kërkesat RoHS dhe WEEE, për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme dhe riciklimin e pajisjeve, si dhe të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit (Declaration of Conformity – DoC) të prodhuesit.

Pajisja duhet të jetë e pajisur me certifikimin CE, të jetë në përputhje me kërkesat ErP, si dhe të disponojë etiketën e efikasitetit energjetik dhe/ose deklaratën e konformitetit.

3. Kërkesa të tjera

Operatori ekonomik fitues duhet të marrë përsipër:

- Transportin e pajisjeve deri në vendin e instalimit.
- Montimin e njësive të brendshme dhe të jashtme.
- Sigurimin dhe instalimin e tubacioneve të bakrit, së bashku me izolimin përkatës.
- Sigurimin dhe instalimin e kablllove elektrike dhe të komunikimit.
- Sigurimin dhe vendosjen e kanalave dhe aksesoreve të nevojshëm për montim.
- Sigurimin dhe montimin e mbajtëseve metalike për njësitë e jashtme.
- Testimin, vënien në punë dhe dorëzimin funksional të pajisjeve.

Kushtet që duhet të plotësojnë prodhuesi dhe operatori ekonomik fitues janë të njëjta me ato të përcaktuara në "Katalogun e blerjes së pajisjeve të kondicionimit", të publikuar në faqen zyrtare të Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, në seksionet "Të dhënat teknike të përgjithshme" dhe "Prokurimi i Gjellbër në Sistemet HVAC (Heating, Ventilation and Air Conditioning)".

Operatori ekonomik fitues duhet të garantojë:

- Garanci minimale 3 (tre) vjet për pajisjet.
- Garanci minimale 1 (një) vit për instalimin.
- Ofrimin e shërbimit teknik gjatë gjithë periudhës së garancisë.

Pajisjet e ofruara duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe të certifikuara në përputhje me standardet evropiane në fuqi.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT